



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.2119/23

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit NTP “MOLIKA”, me seli në fshatin Matiqan, Komuna e Prishtinës, me NRB: 70511657, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.M. avokat nga Prishtina, kundër debitorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me adresë sheshi “Nëna Terezë” nr.36 në Prishtinë, me NUI: 811290808, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1870/23 të datës 22.11.2023, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 05.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1870/23 të datës 22.11.2023, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NTP “MOLIKA”, në bazë të titullit ekzekutiv Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.447/12 të datës 10.01.2022, ka nxjerrë urdhrin P.nr.1870/23 të datës 22.11.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij urdhri, kreditorit t’ia përmbush detyrimin në shumën prej 264,364.00 Euro, në emër të zhdëmtimit të dëmit material të shkaktuar në objekt, si dhe shumën prej 23,756.00 Euro, në emër të dëmeve në makineri, në shumë të tërësishme prej 288,120.00 Euro, me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga

data 17.10.2012, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontesimore dhe shpenzimet përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim ndaj urdhrin përbarimor, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për shkak se propozimit për përbarim nuk i është bashkëngjitur dokumenti përbarues konform nenit 36 të LPP-së dhe është në kundërshtim me nenin 38 të LPP-së. Tutje ka theksuar se urdhri për përbarim është i përfshirë me të meta substanciale pasi që debitori ka pranuar vetëm kopjen e titullit përbarues, dhe kjo e bën urdhrin të paligjshëm dhe rrjedhimisht të anulueshëm, pasi që propozimi për përbarim nuk është bërë konform nenit 38 par.1 të LPP-së. Ka shtuar se urdhri për përbarim është i parakohshëm pasi që kreditorët nuk kanë paraqitur kërkesë tek debitori për përmbushje vullnetare të aktgjykimit, ku në atë kërkesë do të paraqitej numri i xhirlogarisë në të cilën do të bëhej transferimi i mjeteve, e që për debitorin ka qenë e panjohur llogaria dhe nuk ka pasur asnjë mundësi të përmbushjes vullnetare të aktgjykimit në afatin parativ. Debitori ka potencuar se ka paraqitur revizion ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë dhe Aktvendimit të shkallës së dytë, meqenëse ka argumente të mjaftueshme që e bëjnë kërkesëpadinë të pabazuar. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, dhe të anulohet urdhri i Përbaruesit Privat.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilin ka theksuar se debitori qëllimisht dhe me prapavijë të zvarritjes së kësaj çështje përbarimore ka shtrembëruar të vërtetën materiale, dhe se prapësimi është paraqitur në kundërshtim me normat e nenit 71 të LPP-së. Ka shtuar se pretendimet e debitorit, janë të pabazuara dhe të kundërligjshme, për faktin se dihet botërisht se urdhri përbarues është nxjerrë nga Përbaruesi Privat me kompetencë lëndore dhe territoriale dhe se revizioni si mjet i jashtëzakonshëm nuk e ndal ekzekutimin e aktgjykimit të plotëfuqishëm dhe të ekzekutueshëm. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i kundërligjshëm dhe i pabazuar, ndërsa urdhri përbarimor të ekzekutohet, gjegjësisht të vazhdohet me procedurën përbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën

Përmbare, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbareues ka lejuar përmbareimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbareues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbareimin vetëm në bazë të dokumentit përmbareues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbareimor, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.447/12 të datës 10.01.2022, në bazë të së cilit Përmbareuesi Privat ka lejuar përmbareimin dhe gjeti se i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbareues sipas të cilit mund të caktohet përmbareimi.

Gjykata gjeti se aktgjykimi i lartcekur i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbareimor është i përshatshëm për përmbareim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, objektin e detyrimit të debitorit dhe kohën e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.447/12 i datës 10.01.2022, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe me nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbareim, organit përmbareues i dorëzohet edhe dokumenti përmbareues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbareueshmërisë për përmbareueshmëri”*, ndërsa sipas par.2 të këtij neni përcaktohet se *“Vërtetimin për përmbareueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase në shkresat e lëndës aktgjykimi në fjalë është deponuar në origjinal, si dhe është bërë i plotfuqishëm me datë 31.08.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 26.10.2023, e cila vërtetohet nga shënimi zyrtar i datës 03.11.2023, i lëshuar nga Gjykata Komerciale e Kosovës, i cili është i bashkangjitur në shkresat e lëndës.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, por gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrit përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08 L-015 për Gjykatën Komerciale, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2119/23, më datë 05.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.